

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Elva 2001’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mivas’, me kapacitet të instaluar 1940 kw” botuar në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 22.1.2020,

Bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 1 e vendimit nuk ka asnjë ndryshim dhe ka këtë përmbajtje: “Të licencojë shoqërinë ‘Elva 2001’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mivas’, me kapacitet të instaluar 1940 kw, për një afat 30-vjeçar”.

Pika 2 e vendimit ishte: Shoqëria “Elva 2001” sh.p.k të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumente/leje.

Pika 2 e vendimit bëhet: Shoqëria “Elva 2001” sh.a. duhet të depozitojë në ERE: a) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Gramsh, brenda datës 25.3.2029, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike; b) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Skrapar, brenda datës 16.7.2026, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë, ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 3 e vendimit ishte: Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Pika 3 e vendimit bëhet: Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë: 3. Shoqëria “Elva 2001” sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Mivas”, brenda datës 5.10.2028.

Pika 4 e vendimit ndryshon dhe merr përmbajtjen e pikës 3 së mëparshme dhe me konkretisht: Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 29.1.2024, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Elva 2001’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mivas’, me kapacitet të instaluar 1940 kw” botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 5.3.2024,

Bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 1 e vendimit ishte: Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019, ndryshon dhe bëhet: 2. Shoqëria “Elva 2001” sh.a. duhet të depozitojë në ERE: a) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Gramsh, brenda datës 25.3.2029, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë, ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike; b) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Skrapar, brenda datës 16.7.2026, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë, ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1 e vendimit bëhet: “Të licencojë shoqërinë ‘Elva 2001’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mivas’, me kapacitet të instaluar 1940 kw, për një afat 30-vjeçar”.

Pika 2 e vendimit merr përmbajtjen e pikës 1 së mëparshme të vendimit nr. 13, datë 29.1.2024 dhe më konkretisht: 2. Shoqëria “Elva 2001” sh.a. duhet të depozitojë në ERE: a) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Gramsh, brenda datës 25.3.2029, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike; b) kontratën e rinovuar të qirasë me Bashkinë Skrapar, brenda datës 16.7.2026, ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonë ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 3 e vendimit merr përmbajtjen e pikës 2 së mëparshme të vendimit nr. 13, datë 29.1.2024 dhe më konkretisht: *Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë: 3. Shogëria "Elva 2001" sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Mivas", brenda datës 5.10.2028.*

Pika 4 e vendimit merr përmbajtjen e pikës 3 së mëparshme të vendimit nr. 13, datë 29.1.2024, dhe më konkretisht: *Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë: 4. Në rast se shogëria "Elva 2001" sh.a. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, sikurse përcaktohet në pikën 3 të këtij vendimi, dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*

Pika 5 e vendimit merr përmbajtjen e pikës 4 së mëparshme të vendimit nr. 13, datë 29.1.2024, dhe me konkretisht: *Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë: 5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit të kushteve të tij.*

Pika 6 e vendimit merr përmbajtjen e pikës 5 së mëparshme të vendimit nr. 13, datë 29.1.2024, dhe me konkretisht: *Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Elva 2001" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.*